

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

EDUKIMI

1. Përmirësimi i cilësisë së programeve të studimit, rezultateve të të nxënit dhe profilet e të diplomuarve edhe në raport me nevojat e individëve dhe shoqërisë.
2. Çelja dhe ristrukturimi i programeve të reja në përmbushje të kërkesave të tregut.
3. Përmirësimi i kurrikulës me bazë rezultatet e të nxënit.
4. Përmirësimi i shërbimeve në mbështetje të studentit për të rritur cilësinë e studimeve dhe jetës studentore.
5. Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies duke përdorur metodologji të reja (p.sh. mësimi elektronik, të nxënit nëpërmjet TIK-ut) dhe nxitja e kualifikimit të stafit akademik në përmirësimin e aftësive pedagogjike.

KËRKIMI

1. Mbështetja për kërkimin shkencor dhe nxitja e kërkimeve të aplikuara në shërbim të zhvillimit të individëve dhe shoqërisë.
2. Përmirësimi dhe rritja e rezultateve kërkimore në UNIKO.
3. Përmirësimi dhe forcimi i marrëdhënieve të UNIKO me tregun e punës dhe shoqërinë.
4. Mbështetja institucionale për kualifikimin e stafit.